



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 1689/19 prot

Tiranë, më 31/08 2022

URDHËR

Nr. 222/4 datë 31/08 2022

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.722, DATË 11.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E DOKUMENTACIONIT
PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT
PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE”,**

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, “Për Asistencën Sociale në RSH”, pikat 4 dhe 16 të kreut IV, të VKM nr.722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, gjërmat a, b, c dhe ç, të pikës 2 të kreut IV të VKM nr.431, datë 08.06.2016, “Për përcaktimin e masës, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot” si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr.722, datë 11.11.2019, është 12.153 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gjërma “a”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 7292 (shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gjërma “b”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 9723 (nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “c”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 12.153 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “ç”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 14.584 (katërbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 14.584 (katërbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet herëpashërshme të ndihmësit personal, është 9723 (nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi



Konceptoi: H. Rapo
Miratoi: G. Minxho
Kopje: 16
Data: 31.08.2022